

PROJEKTI PERSPEKTIVA TË REJA

Thirrje për aplikime mbi pjesëmarrjen
“Konkurs për Ide inovative biznesi”

NJOFTIM I RËNDËSISHËM:

APLIKIMET DUHET TË PLOTËSOHEN ONLINE NË PËRPUTHJE ME UDHËZIMET MË POSHTË:

deri në datën **08/12/2023**

1. Informacion i përgjithshëm për projektin

Projekti 'Perspektiva të Reja' (PtR) financohet nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar dhe zbatohet nga Swisscontact, në partneritet me TAG International, i cili do zbatohet përgjatë periudhës Shtator 2022 – Mars 2026. Projekti synon përmirësimin e kushteve kyçe socio-ekonomike që shpesh i shtyjnë njerëzit të migrojnë në mënyrë të parregullt në Mbretërinë e Bashkuar nga veriu i Shqipërisë (Kukës, Has, Tropojë, Dibër).

Projekti fokusohet në tre objektiva kryesore:

- Rritja e qëndrueshmërisë së komuniteteve ndaj presioneve për të emigruar në mënyrë të parregullt në Mbretërinë e Bashkuar.
- Përmirësimi i kushteve dhe mundësive social-ekonomike në Qarkun e Kukësit dhe Bashkinë e Dibrës, veçanërisht për të rinjtë.
- Të përmirësojë marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve, sektorit privat dhe pushtetit vendor për zhvillimin ekonomik lokal.

2. Konkurs për plane inovative biznesi.

Projekti "Perspektiva të Reja" shpall thirrjen për shprehje interesi nga individë / mikro-biznese të interesuar për të marrë pjesë në konkursin për plane inovative biznesi në bashkitë e Kukës, Dibër, Has dhe Tropojë, në sektorët e përzgjedhur (përpunim ushqimor, turizëm/agro-turizëm, bimë aromatike dhe mjekësore, fruta pylli dhe teknologji informacioni dhe komunikimi).

Qëllimi kryesor i Konkursit të Ideve inovative të biznesit është të ndihmojë sipërmarrësit e vegjël të përmirësojnë kapacitetet e tyre të planifikimit dhe zhvillimit të biznesit me anë të trajnimeve të specializuara nga ekspertë zhvillimi biznesi dhe ofrimit të mbështetjes financiare për përmirësimin/zgjerimin e bizneseve.

Më konkretisht, Konkursi i ideve inovative të biznesit synon:

- ✓ Të identifikojë iniciativat e sipërmarrjeve private me potencial të lartë rritje, të afta për të nxitur zhvillimin e ekonomisë së vendit ku operojnë dhe për të krijuar vende pune në bashkitë e përzgjedhura;
- ✓ Të promovojë të menduarit inovativ sipërmarrës midis sipërmarrësve të rinj në 5 sektorët e përzgjedhur;
- ✓ Të nxisë të menduarit inovativ të biznesit, një ekosistem të gjallë sipërmarrës në qarkun Kukës dhe bashkinë Dibër;
- ✓ Të mbështesë me grante në vlerën deri 500,000 Lek, fituesit e planeve më inovative të biznesit.

3. Kush mund të aplikojë?

Sipërmarrës të rinj të moshës 18-40 vjeç, me nisma të reja dhe/ose inovative për përmirësimin e mikrobizneseve ekzistuese në sektorët e mëposhtëm:

- i. Përpunim ushqimor
- ii. Turizëm/Agroturizëm
- iii. Bimë mjekësore dhe aromatike
- iv. Frutat e pyllit
- v. Teknologji informacion dhe komunikimi

Pas seleksionit të planeve më inovative të biznesit, 10 individë/mikro-biznese nga Bashkitë Kukës, Has, Bajram Curri, Dibër, do të mentorohen dhe trajnohen për përmirësimin e planeve të biznesit dhe teknikat e prezantimit në publik nga ekspertët e zhvillimit të biznesit, pjesë të projektit 'Perspektiva të Reja'.

Kriteret:

- ✓ Individë / mikro biznese ekzistuese nga bashkitë Kukës, Has, Bajram Curri dhe Dibër.
- ✓ Pasion për të krijuar dhe zhvilluar plane inovative biznesi në 5 sektorët e sipërpërmendur
- ✓ Mosha 18-40 vjeç.

4. Procesi i aplikimit

Aplikantët e interesuar duhet të plotësojnë formulain e aplikimit online në linkun e mëposhtëm:

Linku: <https://forms.office.com/e/Sz1rPE6tvJ>

- ❖ Aplikimi duhet të jetë në gjuhën shqipe.
- ❖ Projekti do të vlerësojë të gjitha aplikimet dhe do të përzgjedhë ato që plotësojnë më mirë kriteret.
- ❖ Aplikimet e paplota nuk do të merren parasysh dhe do të kontaktohen vetëm aplikantët e përzgjedhur.
- ❖ Aplikantët e interesuar duhet të aplikojnë deri me datë **08/12/2023**.
- ❖ Projekti do të jetë i hapur për adresimin dhe përgjigje ndaj pyetjeve tuaja (ekskluzivisht me email) deri në **25/11/2023**.
- ❖ Shpallja përfundimtare e kandidatëve të suksesshëm do të bëhet brenda datës **15/12/2023**.

Komente / pyetje:

Për çdo kërkesë ose koment mos hezitoni të na kontaktoni direkt në: np.dfs@swisscontact.org

Stafi i projektit
„Perspektiva të Reja“